

# СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

08.07.2016

## V E N D I M

I Komisionit për ankesa pranë Këshillit për etikë në mediat e Maqedonisë (KEMM), pas ankesës së Elida Zulfearit, për tekstin me titull “Gazetarët jeshilë, të cilët mbajnë “biberonë” në gojë, së pari ta recensojnë “Portalb-in”, e pastaj mediat tjera!”, i publikuar më 16.05.2016, në ora 13 e 53 minuta, në internet portalin Zhurnal ([www.zhurnal.mk](http://www.zhurnal.mk))

## A N K E S A Ë S H T Ë E J U S T I F I K U A R

Është shkelur Kodi i gazetarëve të Maqedonisë edhe atë Neni 13, 15 dhe 16.

Neni 13.

*“Gazetari duhet të bëjë dallim mes fakteve dhe mendimeve, mes lajmit dhe komentit.”*

Член 15.

*“Gazetari duhet ta kultivojë gjuhën e mirëkuptimit dhe të etikës.*

*Komunikimi i pashembullt me opinionin është i papranueshëm për profesionin e gazetarit.”*

Член 16.

*“Gazetari do të ruaj reputacionin dhe dinjitetin e profesionit të tij, do të nxisë solidaritetin e ndërsjellë dhe pluralizmin e mendimeve dhe nuk do ta përdor median e tij për të qëruar hesaspet me individë, duke inkuadruar edhe kolegët e tij..”*

## A R S Y E T I M I



# СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

Më 16.05.2016 Elida Zulbeari dorëzoi ankesën e saj deri te Zyra Ekzekutive e Këshillit për etikë në mediat e Maqedonisë lidhur me tekstin me titull “Gazetarët jeshilë, të cilët mbajnë “biberonë” në gojë, së pari ta recensojnë “Portalb-in” e pastaj mediat tjera!”, i publikuar më 16.05.2016, në ora 13 e 53 минути, në internet portalin Zhurnal ([www.zhurnal.mk](http://www.zhurnal.mk)).

Në këtë ankesë theksohet se në tekst vërehen elemente të gjuhës së urrejtjes, dhe se është shkelur privatësia, nuk është përfaqësuar pala e dytë dhe është bërë shpifje dhe nënçmim.

Zyra ekzekutive e KEMM-it, në përputhshmëri me Nenin 12 të Rregullores së Komisionit për ankesa, pas pranimit dhe shqyrtimit të ankesës, kontaktoi me portalin Zhurnal dhe kërkoi nga redaktuesit të prononcohen lidhur me pretendimet në ankesë. Portali në fjalë nuk dorëzoi përgjigje ndaj akuzave të ankuesit.

Komisioni për ankesa konstatoi se ankesa lidhur me përmabjtjen është e JUSTIFIKUAR.

\*\*\*

Në mbledhjen që u mbajt më 23.06.2016, Komisioni për ankesa shqyrtoi pohimet e ankuesit Elida Zulbeari dhe inspektoi tekstin në fjalë.

\*\*\*

Komisioni për ankesa konstatoi se në tekstin kontestues me titull “Gazetarët e gjelbër të cilët mbajnë “biberonë” në gojë, së pari ta recensojnë “Portalb-in” e pastaj mediat tjera!”, i publikuar më 16.05.2016, në 13 e 53 minuta në internet portalin Zhurnal, është shkelur Neni 13, sipas të cilit gazetarët kanë të drejtë të mendimit, të qëndrimit të tyre, dhe gjykimit të vlerave por nuk guxojnë që mendimet e tyre t’i kamuflojnë si fakte. Patjetër duhet të ekzistojë dallim i qartë ndërmjet fakteve dhe informacioneve, komenteve dhe hamendjeve apo qëndrimit të autorit, me qëllim që të evitohet dezinformimi dhe manipulimi me publikun.



# СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

Komisioni konstatoi se është shkelur Neni 15 nga Kodi, sipas të cilit gazetari duhet të kultivojë gjuhën e mirëkuptimit dhe të etikës. Komunikimi i pashembullt me opinionin është i papranueshëm për profesionin e gazetarit.

Komisioni konstatoi se është shkelur Neni 16, sipas të cilit gazetari Gazetari do të ruaj reputacionin dhe dinjitetin e profesionit të tij, do të nxisë solidaritetin e ndërsjellë dhe pluralizmin e mendimeve dhe nuk do ta përdor median e tij për të qëruar hesaspet me individë, duke përfshirë edhe kolegët e tij.

Në përputhshmëri me këtë, Komisioni vendosi si në dispozitiv.

Në punën e Komisionit për ankesa morrën pjesë anëtarët Mirçe Adamçevski, Teofill Bllazhevski, Goce Gerasimovski, Filip Gjurçinovski dhe Bekim Ajdini.

**Në bazë të Nenit 18 të Rregullores për punë të Komisionit për ankesa, obligohet internet portali Zhurnal ([www.zhurnal.mk](http://www.zhurnal.mk)), ta publikojë vendimin e Komisionit për ankesa.**

Me respekt,  
Këshilli për etikë në mediat e Maqedonisë

Kryetar i Komisionit për ankesa  
Mirçe Adamçevski

